



BASHKIA SELENICË

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SELENICË
NJËSIA E PROKURIMIT**

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës – Mall

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

Naftë 09134000-7, Benzinë 09132000-3

OBJEKTI I PROCEDURËS: “BLERJE KARBURANTI (BENZINË NAFTË)”

VLERA E FONDIT LIMIT: 15.900.000 (Pesëmbëdhjet milion e nëntëqind mijë) lekë Pa TVSH

1. Njësia e Prokurimit për argumentimin e fondit limit j’u referua çmimeve të tjera zyrtare, Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar, nenit 76 si dhe aktit normativ nr.5, datë 12.3.2022.

“Për disa shtesa në ligjin nr.8450, datë 24.2.1999, “për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre”, të ndryshuar.

Në përllogaritjen e vlerës limit të kontratës, autoriteti/enti kontraktor duhet t’i referohet një ose më shumë alternativave të renditura, si më poshtë vijon:

a) çmimet e botuara nga Instituti i Statistikave (INSTAT), ose/dhe çmime të tjera zyrtare, të njohura nga institucionet përkatëse (si për shembull, nga organet tatimore a doganore, dhomat e tregtisë, në manuale etj.); ose/dhe

b) studimit të tregut, bazuar në mesataren e çmimeve të marra nga ky studim;
ose/dhe

c) çmimet e kontratave të mëparshme, të realizuara nga vetë apo nga autoritete të tjera kontraktore;
ose/dhe

ç) çmimet ndërkombëtare të shpallura publikisht.

e) Ne buletin e publikuar nga angjencia e prokurimit publik

Autoriteti/enti kontraktor mund t’i referohet një ose më shumë alternativave të mësipërme në përllogaritjen e vlerës limit të kontratës, me qëllim që ajo të jetë një vlerë reale për kushtet e tregut dhe njëkohësisht të krijojë mundësinë e pjesëmarrjes së sa më shumë operatorëve ekonomikë.

Përsa më sipër Bashkia Selenicë i është referuar buletin të Agjencise të Prokurimit Publik Nr. 14 Datë, 16.02.2026, si dhe kursit të këmbimit valutorë USD të Bankës së Shqipërisë më datë 19.02.2026.

2. Autoriteti/enti kontraktor, përpara nxjerrjes së urdhrat të prokurimit, duhet të argumentojë dhe të dokumentojë përllogaritjen e vlerës së kontratës, bazuar në specifikimet teknike të objektit që prokurohet.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, autoriteti/enti kontraktor **Bashkia Selenicë** ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

Kjo pikë plotësohet me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 9.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 40, pika 5, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2022, 2023 dhe 2024, ku vlera e xhiros minimale vjetore, duhet të jetë jo më e vogël se 40% e vlerës së përlogaritur të kontratës. Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën 1(një) vit të periudhës së kërkuar të viteve financiare.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. Autoriteti Kontraktor ka konsideruar te nevojshme përfshirjen e kriterit të cituar më lart, në mënyrë që t’i shërbejë autoritetit/entitetit kontraktor për njohjen e gjendjes financiare të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës të mundshëm si dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës. Kërkesa e mësipërme është në përpjesëtim dhe e lidhur ngushtë me objektin e kontratës. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në ligjin nr.8438 datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, neni 29. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në VKM “Për rregullat e prokurimit publik”, e cila paashikon se Autoriteti kontraktor për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike mund të kërkojë për një periudhë maksimumi deri në 3 vitet e fundit financiare. Kjo është një kërkesë e cila nuk e pengon konkurrencën dhe është e bazuar në garancinë që ofertuesi i paraqet Autoritetit Kontraktor.

Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e xhiros që mund të kërkohej, autoritetet/entitetet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të xhiros brenda këtij marzhi.

2.2.2. Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë kopje të bilanceve, të certifikuara nga autoritetet përkatese (Dega e Tatim Taksave) për vitet 2022, 2023 dhe 2024 ku të paktën në dy bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit

të fushës, konkretisht, *nenit 41, të ligjit Nr. 10 091*, datë 5.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar “Personat juridikë që detyrohen për auditimin ligjor të pasqyrave financiare”, përcaktohen rastet kur personat juridikë kanë detyrimin që të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikimit të tyre, nga eksperte kontabël ose shoqëri audituese.

2.3.1 Furnizime të ngjashme në një vlerë jo më të vogël se 20 % fondit limit, të ekzekutuar gjatë 3 tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës:

a) Kur furnizimet janë realizuar me entet publike duhet të paraqitet kontrata e ngjashme me entin që ka realizuar këtë lloj furnizime shoqëruar me vërtetimin e realizimit me sukses nga autoriteti kontraktor.

b) Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturën përkatëse tatimore të shitjes të deklaruara në organet tatimore ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara e firmosur dhe vulosur nga palët.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 4 (ose në rastin e procedurave të thjeshtuara në nenin 55, pika 4/b), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 40 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e kontratave të ngjashme që mund të kërkohet, autoritete/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të kontratave të ngjashme brenda këtij marzhi. **Me një marzh fitimi jo më të madhe se 13%.**

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur me leje tregtimi ose autorizim për karburantët përkatëse e lëshuar nga organet përkatëse, mbështetur në ligjin 8450 datë 24/02/1999 “Për përpunimin, transportimin e naftës dhe nënprodukteve të tjera” me ndryshimet përkatëse.

Argumentim: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenit 40, pika 5, gërma a,) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe Në zbatim të Ligjit nr.8450, datë 24.02.1999, “Për përpunimin,transportimin dhe tregëtimin e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre”, i ndryshuar, VKM nr.147, datë 21.03.2007 “Për cilësinë e lëndëve djegëse benzinë dhe diesel”, VKM nr.970, datë 02.12.2015 “Për përcaktimin e procedurave dhe kushteve për dhënien e licensave për tregëtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj” për tregëtimin e këtyre produkteve, VKM nr.344, datë 19.04.2017, “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin në VKM nr.970, datë 02.12.2015 ”Për përcaktimin e procedurave dhe kushteve për dhënien e licensave për tregëtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj” për tregëtimin e këtyre produkteve të saj”, Vërtetim teknik nga ISHTI është vërtetimi që lëshohet për respektimin e normave dhe kushteve teknike në instalimet teknologjike) sipas urdhërit nr. 315 date 24.08.2017 të Ministrisë .

Për procedurat e lëshimit të vërtetimit teknik për subjektet që kryejnë aktivitet në fushën e përpunimit, transportimit dhe tregëtimin të naftës dhe nënprodukteve të saj.

2.3.3 Operatori ekonomik duhet të paraqesë një vërtetim të lëshuar nga ISHTI, që subjekti ofertues ka tregtuar karburante sipas standarteve të legjislacionit Shqiptar, dhe nuk ka patur penalitete për shkelje të cilësisë për vitin e fundit.

Argumentim: Ky kriter është vendosur nga ana e AK në zbatim të kërkesave që përcakton Ligji

nr.8450, datë 24.02.1999, “Për përpunimin, transportimin dhe tregëtimin e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre”, i ndryshuar, VKM nr.147, datë 21.03.2007 “Për cilësinë e lëndëve djegëse benzinë dhe diesel”, VKM nr. 970, datë 02.12.2015 “Për përcaktimin e procedurave dhe kushteve për dhënien e licensave për tregëtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj” për tregëtimin e këtyre produkteve, VKM nr 344, datë 19.04.2017, “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin në VKM nr. 970, datë 02.12.2015 ”Për përcaktimin e procedurave dhe kushteve për dhënien e licensave për tregëtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj” për tregëtimin e këtyre produkteve të saj”, Urdhërit nr.315, date 24.08.2017 “Për procedurat e lëshimit të vërtetimit teknik për subjektet që kryejnë aktivitet në fushën e përpunimit, transportimit dhe tregëtimit të naftës dhe nënprodukteve të saj”. Plotësimi i këtij kriteri garanton zbatimin e kontratës gjatë periudhës së zbatimit duke treguar që OE ofertues në aktivitetin e tij periodik zbaton rregullat dhe ligjet në fuqi.

2.3.4 Pika e karburantit të jetë e pajisur me autorizim për tregim karburanti i lëshuar nga njësia vendore ku ushtron aktivitetin. (Autorizim duhet të jetë në emër të operatorit ekonomik pjesëmarrës në tender)

Argumentim: Ky kriter është vendosur nga ana e AK në zbatim të kërkesave që përcakton ligji nr. 8450, datë 24.2.1999 “Për përpunimin, transportimin dhe tregëtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre”, i ndryshuar me ligjin nr. 71/2014, neni 4 dhe neni 20, pika

2.3.5 Operatori Ekonomik duhet të paraqesë Fletë Analize, lëshuar nga DPS ose nga laboratore shqiptar i certifikuar, ose i huaj (materiali duhet i perkthyer dhe i noterizuar), që vërteton cilësinë e produkteve objekt prokurimi (gazoil 10 ppm dhe benzinë premium 10 ppm), lëshuar jo më parë se katër mujori i fundit i vitit 2025. Ky kriter plotësohet me dorëzimin e Fletë Analizave

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 4, të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

2.3.6 Subjekti duhet të deklarojë, se merr përsipër furnizimin me karburant në çdo ditë me shërbim 24 ore, sipas nevojave që **ka Autoriteti Kontraktor**.

2.3.7 Operatori/et Ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë ku duhet të kryejnë furnizimin e sasisë së karburantit nëpërmjet kartave elektronike të personalizuara për çdo automjet të Autoriteteteve Kontraktore.

2.3.8 Subjekti duhet të Deklarojë se e zotëron dhe e mundëson pajisjen e Autoriteti Kontraktor me Sistemin Elektronik të Vetmenaxhimit të karburantit.

- Bazuar në VKM Nr. 561 datë 29.07.2016 “Për Standartizimin dhe disiplinimin e shpenzimeve të karburantit në njësitë e qeverisjes së përgjithshme “Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të ofrojnë një faqe menaxhimi të karburanteve (webpage), ku furnizimi dhe shpenzimi i karburantit të kryhet nëpërmjet kartës elektronike të personalizuar me të dhënat e mjetit.

- Faqja e menaxhimit të karburanteve (webpage) duhet të ofrojnë shërbimin e ngarkimit të sasisë së karburantit nga Operatori ekonomik drejt Autoritetit Kontraktor, me qëllim që rimbushja e kartave elektronike të personalizuar me të dhënat e mjetit si dhe administrimi i sasisë së karburanteve të kryhet në mënyrë të pavarur nga vet Autoriteti kontraktor.

- Faqja e menaxhimit të karburanteve (ëebpage) duhet të ofrojnë informacion dhe raporte të ndryshme të lëvrimit dhe qarkullimit të karburantit, të jetë e pavarur dhe e kontrollueshme nga vet Autoriteti Kontraktor.

- Mos ofrimi i shërbimeve të kërkuara mësipër në mënyrë elektronike nëpërmjet Fages së menaxhimit të karburanteve (ëebpage), që ofron çdo operator ekonomik pjesëmarrës përbën kusht për skualifikim.

2.3.9 Operatorët Ekonomike pjesëmarrës duhet te deklaroje qe ka shlyer te gjitha taksat dhe tarifat vendore leshuar nga të gjitha Njësitë Vendore ku Operatori ekonomik ka ushtruar aktivitet gjatë vitit 2025 duke përfshirë këtu **këstet e maturuara të vitit 2026**, dhe duke e bazuar ne për të gjitha vendet e ushtrimit të aktivitetit sipas Ekstraktit të Qendrës Kombëtare të Biznesit për të cilat duhet të paraqesi një vërtetim nga organet e njësisë vendore ku ushtron aktivitetin sipas përcaktimeve te ligjit te Prokurimit Publik dhe të Ligjit nr.Nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar. (Në rastet e bashkimIt të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar I grupit duhet të dorëzojë vërtetimin e lëshuar nga Autoriteti përkatës në të cilën është regjistruar sipas QKB).

Kjo kërkesë do të quhet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me paraqitjen e nje deklarate. Bazuar nëpërcaktimet e nenit 26, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin”.

Argumentimi: Janë kërkuar këto kritere në përputhje me nenin 77, pika 5 të LPP si dhe në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore“ i ndryshuar, neni 5, pika c, sipas afateve të miratuara të kryerjes së pagesave të përcaktuara nga çdo njësi e qeverisjes vendore për për vitin 2023-2024 në të gjitha vendet ku ushtron aktivitet ekonomik sipas të dhënave të QKB-së.

2.3.10 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kësaj kontrate duhet të disponojë një staf punonjësish prej **3 persona me kohe te plote**. Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponimin e numrit minimal të punonjësve në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

Argumentim: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 5/c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë punëtore të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

2.3.11 Operatori ekonomik pjesemarres, duhet të ketë minimumi 1 (nje) pike shitje karburanti të provuar me dokument ligjor (ekstrakti tregtar i QKR-se, Certificate pronesia, kontratë noteriale qeraje ose dokument tjeter ligjor) në territorin e Bashkisë Selenicë.

Argumentimi: Në bazë të nenit të 77, të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, si edhe nenit 40 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar. Kërkesa e mësipërme, është e nevojshme për garantimin e furnizimit me karburant te mjeteve motorike pa pasur nevojë të bëhen shumë kilometra vetëm për tu furnizuar.Vendosja e këtij kriteri është e rëndesishme për autoritetin, për të vërtetuar qendrueshmërinë e ofertuesit, dhe besueshmërinë në përmbushjen e sukseshme të kontratës. Kerkesa e mesiperme, mbeshtetet me teper ne nje llogjike te qarte dhe te thjeshte, qe konsiston ne faktin qe ; automjeti per t’u furnizuar me karburant, nuk ka pse te pershkoje nje distance, jo te nevojshme vajtje-ardhje, duke humbur keshtu kohe dhe gjithashtu duke rritur ne menyre artificiale, jo produktive, konsumin e karburantit,duke qene se Bashkia Selenicë ka mjete qe e kane te nevojshme dhe te domosdoshme te punojne gjate gjithë vitit dhe ne shume raste te emergjencave ne cdo ore te dites.

Argumentimi i specifikimeve teknike

SPECIFIKIMET TEKNIKE PËR BENZINË (premium 10ppm)

Specifikimet teknike për benzinë (premium 10 ppm) duhet të jenë sipas **standartit S SH EN 228**, si më poshtë:

Nr.	Treguesi cilesor	Njësia e matjes	Kufijtë e lejuar	
			Minimale	Maksimale
1	Numri i oktanit kërkimor NOK		95,0	-
2	Numri i oktanit motorik NOM		85,0	-
3	Përmbajtja e Plumbit	mg/l	-	5,0
4	Densiteti (në 15 0 C)	kg/m3	720,0	775,0
5	Përmbajtja e squfurit	mg/kg	-	10,0
6	Përmbajtja e magnezit	mg/l	-	6,0 2,0
7	Stabiliteti ndaj oksidimit	minuta	360	-
8	Përmbajtja e rreshirave faktike (të lara në tretës)	mg/100ml	-	5
9	Korrozioni i shufrës së bakrit (3 orë ne 50 0 C)	renditje	Klasa 1	
10	Pamja e jashtme		E pastër dhe e tejdukshme	
11	Përmbajtja e tipit të hidrokarburit -Olefinat -Aromatiket	%(V/V)	- -	18,0 35,0
12	Përmbajtja e benzenit	%(V/V)	-	1,00
13	Përmbajtja e oksigjenit	%(m/m)	-	2,7
14	Përmbajtja e komponimeve oksigjenore - Metanol (alkol metilik) - Etanol (alkol etilik)	%(V/V)	- -	3,0 5,0
15	-alkol iso- propilik -alkol iso – butilik - alkol terc – butil - etere (me 5 ose më shumë atome C) h	mg/l	- -	Përzierja në vëllim i kufizuar në 2,7 % (m/m) të O2

SPECIFIKIMET TEKNIKE PËR GAZOIL 10 ppm

Specifikimet teknike për gazoil 10 ppm, duhet të jenë sipas **standartit S SH EN 590**, si më poshtë:

Nr.	Treguesi cilesor	Njësia e matjes	Kufijtë e lejuar	
			Minimale	Maksimale
1	Numri i cetanit		51,0	-
2	Indeksi i cetanit		46,0	-
3	Densiteti në 15 C	kg/m3	820,0	845,0
4	Hidrokarburet aromatike policiklike	%(m/m)	-	10,0

5	Përmbajtja e squfurit	mg/kg	-	10,0
6	Pika e flakërimit	oC	Mbi 55	-
7	Përmbajtja e koksit (në 10% mbetje distilim)	%(m/m)	-	0.30
8	Përmbajtja e hirit	%(m/m)	-	0.010
9	Përmbajtja e ujit	mg/kg	-	200
10	Vetitë lubrifikuese, diametri i korrektuar i njollës së gripuar (gërryer)(ësd 1,4) në 60 0 C	um	-	24
11	Korrozioni i shufrës së bakerit (3 orë në 50 oC)	Klasifikim	Klasa 1	
12	Stabiliteti i oksidimit	g/m ³ h	- 20	25 -
13	Viskoziteti në 40 oC	mm ² /s	2.000	4.500
14	Destilimi %(V/N) në 250 oC në 350 oC në 95%(V/N)	% (V/N) o C	85	<65 360
15	Përmbajtja e magnezit	mg/l	- -	6,0 2,0
16	Ndotja e përgjithshme	mg / kg	-	24
17	Përmbajtja e Esteret metilike të acideve yndynore EMAY	% (V/V)	-	7,0

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

Personi pergjegjes:

Specifikimet teknike:

Fondi limt:

